

**UDHËRRËFYESI  
I DREJTAVE TË  
NJERIUT I BE-SË  
PËR LIRINË E  
SHPREHJES  
ONLAJN DHE  
OFLAJN**



# UDHËRRËFYESI I DREJTAVE TË NJERIUT I BE-SË PËR LIRINË E SHPREHJES ONLAJN DHE OFLAJN

## Mbledhja e Këshillit të Punëve të Jashtme

*Bruksel, 12 maj 2014*

Këshilli miratoi udhërrëfyesin në vijim:

### I. PASQYRA DHE DEFINICIONET

#### A. HYRJA

1. Liria e të menduarit dhe të shprehurit janë të drejtat fundamentale të çdo qenieje njerëzore. Të domosdoshme për dinjitetin dhe plotësimin individual, ato gjithashtu formojnë themelet kryesore për demokraci, sundim të ligjit, paqe, stabilitet, zhvillim të qëndrueshëm përfshirës dhe pjesëmarrje në çështjet publike. Shtetet kanë obligim të respektojnë, të mbrojnë dhe të promovojnë të drejtat për lirinë e të menduarit dhe të shprehurit.
2. Liria e të menduarit dhe të shprehurit janë themelore për plotësimin dhe gëzimin e një game të gjerë të të drejtave të njeriut, duke përfshirë lirinë e shoqërimit dhe tubimit, lirinë e të menduarit, fesë ose besimit, të drejtën e arsimit, të drejtën për të marrë pjesë në jetë kulturore, e drejta e votimit dhe të gjitha të drejtat tjera politike që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në çështjet publike. Demokracia nuk mund të ekzistojë pa ato.
3. Liria e të menduarit dhe të shprehurit janë me rëndësi për promovimin e vetë-plotësimit dhe autonomisë së individëve. Liria e të shprehurit, duke përfshirë edhe shprehjen artistike, është thelbësore për zhvillimin dhe manifestimin e identitetit të individëve në shoqëri.
4. Mediat e lira, të shumëllojshme dhe të pavarura janë thelbësore në çdo shoqëri, për të promovuar dhe mbrojtur të drejtën e të menduarit dhe të shprehurit dhe të drejtat e tjera të njeriut. Duke lehtësuar rrjedhën e lirë të informatave dhe ideve mbi çështjet e interesit të përgjithshëm dhe duke siguruar transparencë dhe përgjegjësi, mediat e pavarura përbëjnë një nga gurthemet e shoqërisë demokratike. Pa lirinë e të shprehurit dhe lirinë e mediave, është e pamundur një qytetari e informuar, aktive dhe e angazhuar.
5. Gazetarët punojnë në zbulimin e keqpërdorimeve të pushtetit, duke hedhur dritë mbi korrupsionin dhe duke vënë në pyetje mendimin e pranuar, gjë që shpesh i vendos ata në rrezik të veçantë të kanosjes dhe dhunës. Sulmet dhe kanosjet e këtilla – shpesh herë të shoqëruara me refuzimin e autoriteteve shtetërore për hetim efektiv dhe për t'i dhënë fund mosndëshkimit të këtyre akteve – përfaqësojnë një sulm jo vetëm mbi viktimën, por gjithashtu mund të kufizojë aftësinë e publikut për të pranuar informata dhe ide. Përpjekjet për të mbrojtur gazetarët nuk duhet të kufizohen në ato që zyrtarisht njihen si të tilla, por gjithashtu duhet të përfshijnë stafin mbështetës dhe të tjerët, siç janë 'qytetarët gazetarë', bllogerët,

aktivistët e mediave sociale dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, të cilët shfrytëzojnë mediat e reja për të depërtuar në audiencë të madhe. Përpjekjet për t'i dhënë fund mosndëshkimit të krimeve ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatikë, duhet të asocohen me mbrojtjen dhe ruajtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut<sup>1</sup>.

6. Inovacionet teknologjike në fushën e informimit dhe komunikimit kanë krijuar mundësi të reja për individët, që të shpërndajnë informata për publikun e gjerë dhe kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në pjesëmarrjen dhe kontributin e qytetarëve në proceset e vendim-marrjes. Këto inovacione kanë sjell edhe sfida të reja. Të gjitha të drejtat e njeriut që ekzistojnë në formë të shtypur, duhet gjithashtu të mbrohen në formë elektronike, sidomos e drejta e lirisë së mendimit dhe shprehjes dhe e drejta e privatësisë, e cila gjithashtu përfshin mbrojtjen e të dhënave personale.
7. I drejtuar nga dispozitat relevante<sup>2</sup> të Traktatit për Bashkimin Evropian (TEU) dhe nga Karta e BE-së për të Drejtat Fundamentale dhe në pajtim me obligimet e tyre ndërkombëtare dhe evropiane të të drejtave të njeriut<sup>3</sup>, BE është angazhuar për respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e lirisë së të menduarit dhe të shprehurit në suaza të kufijve të vet. Me këtë Udhërrëfyes, BE-ja vërteton vendosmërinë e vet që në politikën e vet të jashtme për të drejtat e njeriut, të promovojë lirinë e të menduarit dhe të shprehurit, si të drejta që duhet të ushtrohen nga gjithkush dhe kudo, në bazë të parimeve të barazisë, mosdiskriminimit dhe universalitetit. Me anë të instrumenteve të politikës së vet të jashtme, BE-ja synon të ndihmojë në trajtimin dhe parandalimin me kohë të shkeljes së këtyre të drejtave në mënyrë të vazhdueshme dhe koherente.

## B. QËLLIMI I UDHËRRËFYESIT

8. Gjatë promovimit dhe mbrojtjes së lirisë së të menduarit dhe të shprehurit, BE-ja udhëhiqet nga universaliteti, pandashmëria, ndërlidhja dhe ndërvarësia e të gjitha të drejtave të njeriut, qoftë qytetare, politike, ekonomike, sociale ose kulturore. Prandaj, ky udhërrëfyes duhet të lexohet duke marrë parasysh udhërrëfyesit e tjerë të miratuar të BE-së, në fushën e të drejtave të njeriut.
9. Udhërrëfyesi sqaron standardet ndërkombëtare për të drejta të njeriut mbi lirinë e të menduarit dhe të shprehurit dhe siguron udhëzim politik dhe operativ për zyrtarët dhe stafin e institucioneve të BE-së dhe Shteteve Anëtare të BE-së për punën e tyre në vendet e pazhvilluara dhe në forumet multilaterale, si dhe në kontakt me organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe të gjitha palët e interesuara.
10. Udhërrëfyesi gjithashtu u ofron zyrtarëve dhe stafit udhëzime praktike për mënyrën e kontribuimit në parandalimin e shkeljeve të mundshme të lirisë së të menduarit dhe të shprehurit, mënyrën e analizimit të rasteve konkrete dhe reagimi efektiv në rastet e shkeljeve, për të mbrojtur dhe promovuar lirinë e të menduarit dhe të shprehurit në veprimet e jashtme të BE-së. Ai gjithashtu përcakton mënyrën dhe rrethanat e caktuara kur mund të kufizohet liria e të menduarit dhe të shprehurit.

## B. DEFINICIONET

11. E drejta e lirisë së mendimit dhe shprehjes është e përfshirë në Nenin 19 të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut (UDHR) dhe Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejta Civile dhe Politike (ICCPR). Neni

---

<sup>1</sup> Shih Udhërrëfyesin e BE-së për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut (2004, azhurnuar në vitin 2008)

<sup>2</sup> Neni 2, 6, 21, 49 i TEU (Traktati mbi Bashkimin Evropian) dhe nenet 7, 8, 10, 11, 22 i Kartës së BE-së për të Drejtat e Njeriut. Të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së janë pjesëmarrëse në ICCPR dhe ECHR.

<sup>3</sup> Shih shtojcën II për listën e pashterrshme të normave dhe standardeve ndërkombëtare dhe evropiane mbi lirinë e të menduarit dhe të shprehurit.

19 ICCPR thekson se "Të gjithë do të kenë të drejtë të kenë opinionin e vet pa ndërhyrje. Të gjithë do të kenë të drejtë të lirisë të të shprehurit; kjo e drejtë do të përfshijë lirinë për të kërkuar, pranuar dhe për të komunikuar informatat dhe idetë e të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë gojarisht, me shkrim ose në formë të shtypur, në formë të artit ose përmes mediave të tjera që i zgjedhin vet. Ushtrimi i të drejtës së definuar në paragrafin 2 të këtij neni parashikon detyra dhe përgjegjësi të veçanta. Prandaj, mund t'u nënshtrohet kufizimeve të caktuara, të cilat do të jenë vetëm të tilla që përcaktohen me ligj dhe të cilat janë të domosdoshme: (a) Për respektimin e të drejtave dhe reputacionin e të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë nacionale apo të rendit publik, ose shëndetit publik dhe moralit". Një burim i dobishëm i interpretimit të Nenit 19 është komenti i përgjithshëm i Komitetit të OKB-së për të Drejta të Njeriut 34 (UNHRC/GC34)<sup>4</sup>.

#### **a) E drejta e opinionit pa ndërhyrje**

12. Të gjithë kanë të drejtë të kenë opinionin e tyre pa asnjë ndërhyrje. Kjo e drejtë gjithashtu përfshin të drejtën e ndryshimit të opinionit kurdo dhe për çfarëdo arsye që personi zgjedh lirshëm. Asnjë person nuk mund t'i nënshtrohet dëmtimit të të gjitha të drejtave, në bazë të opinioneve të tij apo të saj aktuale, të perceptuar ose të supozuar. Çdo formë ose përpjekje për të ndërhyrë në opinionin e dikujt tjetër, është e ndaluar.
13. Të gjitha format e opinionit janë të mbrojtura, duke përfshirë opinionet e natyrës sociale, politike, shkencore, historike, morale dhe fetare. Shtetet nuk mund të imponojnë asnjë përjashtim ose kufizim të lirisë së të menduarit dhe nuk mund të penalizojnë mbajtjen e një opinioni.

#### **b) E drejta për lirinë e të shprehurit**

##### *i. E drejta për të kërkuar dhe pranuar informata*

14. E drejta për lirinë e të shprehurit përfshin lirinë për të kërkuar dhe pranuar informata. Kjo e drejtë është përbërësi kryesor i qeverisjes demokratike pasi që promovimi i proceseve pjesëmarrëse të vendim-marrjes është i paarritshëm pa qasjen adekuate në informata. Për shembull ekspozimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut, në disa rrethana, mund të asistohet me zbulimin e informatave që mbahen nga entitete shtetërore. Sigurimi i qasjes në informata mund të shërbejë për të promovuar drejtësinë dhe riparimin, sidomos pas periudhave të shkeljes së rëndë të të drejtave të njeriut. Këshilli i OKB-së për të Drejta të Njeriut thekson se publiku dhe individët kanë të drejtë të kenë qasje maksimale në informata, që kanë të bëjnë me veprimet dhe proceset vendim-marrëse të Qeverisë së tyre<sup>5</sup>.
15. Çdo individ duhet të ketë të drejtë të konstatojë në formë të kuptueshme, nëse dhe çfarë të dhënash personale janë mbajtur dhe ruajtur për ata dhe për çfarë qëllimesh. Çdo individ gjithashtu duhet të konstatojë se cilat autoritete publike, cilët individë apo organe kontrollojnë apo mund të marrin vendime duke ndikojnë mbi përpunimin e të dhënave të tij apo të saj, të cilat janë ruajtur onlajn ose oflajn. Nëse dosjet e këtilla përmbajnë të dhëna personale të pasakta ose të dhëna që janë grumbulluar ose përpunuar në kundërshtim me dispozitat e ligjit, çdo individ duhet të ketë të drejtën që të dhënat e tij apo të saj të korrigjohen, apo në rrethana të caktuara edhe të fshihen. Shtetet duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të siguruar qasje të lehtë, të shpejtë, efektive dhe praktike në informatat e këtilla. Është pranuar se mund të jetë relevante që mbrojtja e të dhënave të konsiderohet në kontekst të lirisë së shprehjes.

---

<sup>4</sup> Një koment i përgjithshëm është interpretim jo-detyrues të përmbajtjes së dispozitave për të drejta të njeriut nga organet e traktatit të OKB-së. Komenti i përgjithshëm 34 cakton udhëzimet për palët e shteteve lidhur me interpretimin e aspekteve specifike të Nenit 19 të ICCPR dhe mund ta gjejmë në <http://www2.ohchr.org/english/bodies/hrc/docs/GC34.pdf>

<sup>5</sup> A/HRC/RES/12/12



16. Interneti dhe teknologjitë dixhitale kanë zgjeruar mundësitë e individëve dhe mediave, për të ushtruar lirinë e të shprehurit dhe të kenë qasje të lirë në informatat onlajn. Çdo lloj kufizimi që parandalon rrjedhën e informatave oflajn ose onlajn duhet të jetë në pajtim me kufizimet e lejueshme, siç janë përcaktuar me ligjin ndërkombëtar për të drejta të njeriut.


*ii. E drejta për të komunikuar të gjitha llojet e informatave dhe ideve përmes të gjitha mediave dhe pavarësisht nga kufijtë*

17. Liria e të menduarit dhe të shprehurit më tej përfshin lirinë për të shprehur dhe komunikuar të gjitha llojet e informatave dhe ideve që mund t'u transmetohen të tjerëve, në çdo lloj forme dhe pavarësisht nga mediat. Informatat ose idetë që mund të konsiderohen si kritike ose kontroverse nga autoritetet ose nga një pjesë e madhe e popullatës, duke përfshirë idetë ose qëndrimet që mund të jenë "shokuese, ofenduese ose shqetësuese"<sup>6</sup>, gjithashtu përfshihen nga ky Koment mbi çështjet private ose publike, shqyrtimin, diskutimin mbi të drejtat e njeriut, gazetarinë, hulumtimin shkencor, shprehjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar<sup>7</sup> dhe shprehjen artistike, reklamimin, mësimdhënien dhe të gjithë shembujt e të shprehurit që përfshihen nga liria e të shprehurit. Ajo gjithashtu përfshin diskursin politik dhe reklamat gjatë fushatave zgjedhore.

18. Të shprehurit mund të jetë në forma të ndryshme, duke përfshirë atë gojor, me shkrim dhe gjuhën e shenjave, si dhe të shprehurit përmes imazheve dhe objekteve të artit, të cilat janë të mbrojtura. Mjetet e të shprehurit mund të përfshijnë libra, gazeta, pamflete, posterë dhe banderolla, si dhe të gjitha format dhe mjetet e të shprehurit, si ajo audio-vizuale, elektronike dhe të bazuara në internet

### **Kufizime të përcaktuara në mënyrë rigoroze për të drejtën e lirisë së shprehjes**

19. Gjykatat, mekanizmat dhe konventat ndërkombëtare dhe rajonale për të drejta të njeriut pranojnë se liria e të shprehurit mund të kufizohet me ligj në mënyra të caktuara, rreptë të definuara dhe në rrethana të veçanta. Kufizimet gjatë ushtrimit të lirisë së të shprehurit nuk mund të vënë në rrezik të drejtën. Komiteti i OKB-së për të Drejta të Njeriut ka theksuar në mënyrë të përsëritur se lidhja mes të drejtës dhe kufizimit, dhe mes normës dhe përjashtimit nuk duhet të kthehet mbrapsht.



<sup>6</sup> *Handyside v. the United Kingdom, ECtHR Judgment, 7 December 1976, § 49*

<sup>7</sup> *Dokumenti i Mbledhjes në Kopenhagë të Konferencës së OSBE-së mbi Dimensionin Njerëzor, 1990, paragrafi (32)*

20. Çdo kufizim i këtillë, duhet të kalojë një test kumulativ tre-pjesësh:

- Ato duhet të përcaktohen me ligj, i cili është i qartë dhe i arritshëm për të gjithë (parimi i sigurisë ligjore, parashikimit dhe transparencës)
- Ato duhet të ndjekin një nga synimet e përcaktuara në nenin 19.3 ICCPR, d.m.th. të mbrojnë të drejtat ose reputacionin e të tjerëve; të mbrojnë sigurinë nacionale, rendin publik ose shëndetin apo moralin publik (parimi i legjitimitetit)
- Ato duhet të vërtetohen si të domosdoshme dhe si mjetet me kufizim më të vogël të nevojshëm dhe në përputhje me qëllimin e supozuar (parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit).

21. Në suaza të nenit 20.2 të ICCPR, Shtetet duhet të ndalojnë me ligj "çdo predikim për urrejtje nacionale, racore apo fetare që përmban nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë". Mirëpo, kufizimet e tilla gjithmonë duhet të jenë në proporcion me synimin e ndjekur.

22. Çdo Shtet ka detyrimin për të respektuar të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes, dhe duhet të sigurojë që kjo e drejtë të hyjë në përdorim në ligjin vendor. Çdo legjislacion që kufizon të drejtën për lirinë e mendimit dhe të shprehjes duhet të zbatohet nga një organ që është i pavarur nga ndikimet politike, komerciale ose ndikimet e tjera të pajustificuara, në mënyrë që nuk është as arbitrare dhe as diskriminuese, dhe me kujdesin adekuat kundër keqpërdorimit, duke përfshirë mundësinë e sfidimit dhe përmirësimit për zbatimin e tij abuziv<sup>8</sup>.

## I. UDHËZIMET OPERATIVE

### D. VLERËSIMET E PËRGJITHSHME

23. **E drejta e lirisë së mendimit dhe shprehjes është e drejtë universale:** Liria e mendimit dhe shprehjes vlen për të gjithë personat në mënyrë të barabartë. Ajo duhet të mbrohet gjithkund dhe për çdokënd, pavarësisht nga ajo se kush janë dhe ku jetojnë ata. Ajo duhet të respektohet dhe të mbrohet në mënyrë të njejtë qoftë onlajn apo oflajn.

24. **Shtetet kanë detyrim primar të mbrojnë dhe të sigurojnë të drejtën për lirinë e mendimit dhe shprehjes:** Shtetet duhet të garantojnë se sistemet e tyre ligjore ofrojnë garanca adekuate dhe efektive të lirisë së mendimit dhe shprehjes për të gjithë, të cilat vlejné për gjithë territorin dhe mund të zbatohen në mënyrë të duhur.

25. **Shtetet gjithashtu kanë detyrim të mbrojnë të drejtën e privatësisë, në pajtim me nenin 17 të ICCPR:** Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare ose të paligjshme në privatësinë e tyre. Shtetet duhet të garantojnë që sistemet e tyre ligjore të ofrojnë garanca adekuate dhe efektive për të drejtën e privatësisë, të cilat vlejné për të gjithë që janë në jurisdiksonin e tyre dhe që mund të zbatohen në mënyrë të duhur.

26. Shfrytëzimi i plotë i Udhërrëfyesit ekzistues të BE-së për të drejta të njeriut do të bëhet gjithnjë kur ky do të jetë relevant në trajtimin e shkeljeve të mundshme të të drejtës për lirinë e mendimit dhe shprehjes, respektivisht Udhërrëfyesi për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, për dhunën kundër femrave dhe luftimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër tyre, për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, për torturën dhe dënimin me vdekje, gëzimin e të gjitha të drejtave njerëzore nga personat Lezbikë, Gej, Biseksualë, Transeksualë dhe Hermafrodit (LGBTI) dhe për të drejtën e lirisë fetare apo të besimit<sup>9</sup>.

---

<sup>8</sup> 2011 UNSR Frank La Rue report on Freedom of Expression - A/HRC/17/27  
[http://www2.ohchr.org/english/bodies/hrcouncil/docs/17session/A.HRC.17.27\\_en.pdf](http://www2.ohchr.org/english/bodies/hrcouncil/docs/17session/A.HRC.17.27_en.pdf)

<sup>9</sup> [http://eeas.europa.eu/human\\_rights/guidelines/index\\_en.htm](http://eeas.europa.eu/human_rights/guidelines/index_en.htm)

## B. Fushat Prioritare të Veprimit

27. Në trajtimin e lirisë së shprehjes, BE-ja do t'u kushtojë vëmendje të veçantë temave në vijim, të cilat kanë rëndësi të barabartë:


**1. Luftimi i dhunës, persekutimi, ngacmimi i individëve, duke përfshirë gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave, për shkak të ushtrimit të tyre të të drejtës së shprehjes onlajn dhe oflajn, dhe luftimi i mosndëshkimit të krimeve të tilla**

28. BE-ja angazhohet për promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe shprehjes në mbarë botën dhe ndëshkon shkallën gjithnjë e më të madhe të kanosjes dhe dhunës ndaj gazetarëve, me të cilën përballen aktorët e mediave dhe individë të tjerë në shumë vende të botës për shkak se ushtrojnë të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes onlajn dhe oflajn. Shtetet duhet të ndër marrin hapa aktivë për të parandaluar dhunën dhe për të promovuar mjedis të sigurtë për gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave, duke i aftësuar ata të bëjnë punën e tyre në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrje të panevojshme dhe pa frikë të dhunës ose persekutimit<sup>10</sup>.

29. BE-ja cakton prioritetin më të lartë për sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave. BE-ja do të marrë hapa të duhur për të siguruar mbrojtjen e gazetarëve, si në aspekt të masave preventive ashtu edhe duke nxitur hetime efektive në rastet kur ndodhin shkelje.

BE-ja do të:

- a) Dënojë publikisht vrasjet, sulmet, torturën, zhdukjen me forcë ose akte të tjera të dhunës ose kanosjes së individëve për të ushtruar të drejtën e tij apo të saj të lirisë së mendimit dhe shprehjes, si dhe sulmet mbi mediat; dhe të marrë parasysh masa të duhura plotësuese;
- b) Kërkojë nga autoritetet shtetërore të respektojnë detyrimet e tyre ndërkombëtare, ashtu që të hetojnë krimet e këtilla në mënyrë efektive, të pavarur dhe me saktësi, dhe të sigurojnë sjellen para drejtësisë të kundërvajtësve shtetërorë dhe jo-shtetërorë dhe inicuesve të dhunës së këtyllë. Aty ku është nevoja, BE-ja do të inkurajojë mbikqyrjen ndërkombëtare të gjyqimit, për të siguruar vazhdimësinë lidhur me rastet e dhunës dhe për të nxitur luftën kundër mosndëshkimit;
- c) Apelojë nga Shtetet që të marrin hapa aktivë për të parandaluar dhunën ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias, duke ua bërë të mundur të punojnë në siguri, pa frikë nga dhuna dhe persekutimi;



<sup>10</sup> Rezoluta UNGA A/RES/68/163 "Siguria e gazetarëve dhe çështja e mosndëshkimit"

- d) Inkurajojë fuqishëm zyrtarët shtetërorë dhe aktorët e tjerë me ndikim në shoqëri, të denoncojnë në mënyrë publike aktet e dhunës ose kanosjes ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave, sidomos në rastet kur organet shtetërore kanë inkurajuar ose kanë falur sulmet e këtilla;
- e) Mbështesë implementimin e Rezolutës UNGA mbi "Sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit"<sup>11</sup> dhe Planin e Veprimit të OKB-së mbi temën e njëjtë<sup>12</sup>;
- f) Lehtësojë këmbimin e përvojës me menaxherët e mediave, redaktorët, gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave, për të shtuar vetëdijen, për të zhvilluar kapacitetin e tyre në parandalimin e sulmeve dhe rritjen e sigurisë së gazetarëve, përveç të tjerash përmes masave të trajnimit.
- g) Lehtësojë këmbimin e përvojave të mira me zyrtarët qeveritarë për sigurinë e gazetarëve, duke përfshirë edhe pjesëtarët e gjyqësisë, prokurorisë dhe ushtrimit të ligjit.

## 2. Promovimi i ligjeve dhe përvojave që mbrojnë lirinë e mendimit dhe shprehjes

- 30. Përveç dhunës së drejtpërdrejtë dhe sulmeve mbi sigurinë fizike të gazetarëve, aktorëve të mediave dhe individëve të tjerë, liria e shprehjes shpesh është e cunguar nga ligjet ose përvojat që imponojnë censurën, inkurajojnë vetë-censurën ose të japë dënime ligjore, duke përfshirë sanksionet penale, financiare dhe administrative mbi lirinë e mendimit dhe shprehjes, në shkelje të ligjit ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut.
- 31. Shtetet duhet të mbrojnë me ligj të drejtën e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e tyre<sup>13</sup> në mënyrë që të sigurojnë se gazetarët raportojnë për çështjet e interesit publik, pa frikën e ndëshkimit të burimeve të tyre. Të gjitha qeveritë duhet t'u lejojnë gazetarëve të punojnë në një mjedis të lirë dhe duke mundësuar një mjedis të sigurtë, pa frikë nga censurimi apo kufizimi.

BE-ja do të:

- a) Punojë kundër sulmeve arbitrare, abuzimit të rrëmujshtëm të procedurave penale dhe civile, fushatave të shpifjes dhe kufizimeve të shumta për gazetarët, aktorët e mediave, OJQ-të dhe personalitetet sociale mediatike, të lansuara me qëllim të parandalimit të këtyre shoqatave dhe individëve që lirshëm të ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes.
- b) Dënojë çdo kufizim mbi lirinë e shprehjes dhe censurën, onlajn dhe oflajn, në shkelje të ligjit ndërkombëtar për të drejta të njeriut.
- c) Kërkojë shfyqizimin ose ndryshimin e ligjeve apo përvojave që penalizojnë individët ose organizatat për ushtrimin e të drejtës së tyre në shprehjen e mendimeve ose shpërndarjen e informatave në forumet rajonale bilaterale dhe multilaterale për të drejta të njeriut.
- d) Të llobojë publikisht kundër legjislacionit kufizues që ngushton hapësirën e shoqërisë civile dhe mbrojtësve për të drejta të njeriut që promovojnë dhe mbrojnë lirinë e shprehjes dhe qasjen e tyre në financa.
- e) Të kërkojë lirimin dhe të vëzhgojë gjykimet e gazetarëve ose individëve të tjerë që kanë qenë të paraburgosur ose të arrestuar për shprehjen e qëndrimeve të tyre onlajn dhe oflajn, ose për shpërndarjen e informatave sipas ligjit ndërkombëtar për të drejta të njeriut.
- f) Mbështesë miratimin e legjislacionit që siguron mbrojtje adekuate për informuesit dhe të mbështesë reformat për t'i dhënë mbrojtje ligjore të drejtës së gazetarëve për të mos zbuluar burimet.
- e) g) Inkurajojë këmbimin e përvojave të mira mbi promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe shprehjes me të gjitha palët e interesuara relevante, duke përfshirë: zyrtarët e sundimit të ligjit, gjyqësinë, shoqërinë civile, politikanët, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, gazetarët, forcat e sigurisë, akademikët dhe agjencitë fetare dhe kulturore.

<sup>11</sup> A/RES/68/163

<sup>12</sup> Si reagim ndaj Planit të Veprimit të OKB-së, në mbledhjen e agjencive të OKB-së u hartua Strategjia e Implementimit 2013/2014 (Vienna, nëntor 2012)

<sup>13</sup> Vetëm nëse justifikohet nga një kërkesë thelbësore në interes të publikut, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejta të njeriut.




- h) Vazhdojë të sigurojë gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave, mbrojtësve të të drejtave të njeriut, aktivistët politikë dhe individët e tjerë me mjetet teknike dhe mbështetjen e nevojshme për të ushtruar të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes onlajn dhe oflajn.
- i) Sigurojë që masmedia dhe mediat sociale pranojnë dhe respektojnë të drejtat e fëmijëve, siç është përcaktuar në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve.

### **3. Promovimi i lirisë dhe pluralizmit të mediave dhe kultivimi i kuptimit mes autoriteteve publike lidhur me rreziqet nga ndërhyrja e pajustificuar me raportimi i paanshëm/kritik**

- 32.** Një shoqëri e hapur e bazuar në sundimin e ligjit mund të funksionojë në mënyrë efektive vetëm nëse ekziston një mjedis i pavarur dhe pluralist i mediave të shtypura dhe elektronike. Shtypi i lirë, i shumëllojshëm dhe i pavarur dhe mediat e tjera ofrojnë platforma publike, të cilat janë thelbësore për të gjitha shoqëritë, në mënyrë që të sigurojnë lirinë e mendimit dhe shprehjes dhe gëzimin e të drejtave të tjera të njeriut.

BE-ja do të:

- a) Mbështesë veprimet e vendeve të treta për të siguruar kornizat ligjore, politike dhe rregullatore të bazuara në standardet ndërkombëtare që mbrojnë dhe promovojnë lirinë e shprehjes dhe informimit.
- b) Mbështesë veprimet e vendeve të treta për të miratuar procedurat e nevojshme, në mënyrë që t'u lehtësojnë individëve të pranojnë informata, përfshirë këtu lirinë e ligjeve të informimit.
- c) Promovojë pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrja politike ose komerciale e të gjitha organeve publike që rregullojnë mediat, transmetimin ose telekomunikimet.
- d) Mbështesë veprimet e vendeve të treta për të përmirësuar transparencën e pronësisë së mediave, miratimin e masave kundër koncentrimit të mediave dhe ndarjes së licencimit të drejtë dhe transparent, meqenëse rreziqet përcjellëse janë bërë më akute në epokën dixhitale.
- e) Inkurajojë veprimet e vendeve të treta, për të përmirësuar transparencën dhe përdorimin e drejtë të parave publike në sektorin mediatik.
- f) Mbështesë veprimet e vendeve të treta që synojnë përforsimin e pavarësisë gazetareske dhe redaktuese, duke përfshirë mekanizmat ligjorë dhe financues që përforcojnë vetë-qëndrueshmërinë financiare të mediave publike dhe private.



- g) Inkurajojë promovimin e masave në vendet e treta, veçanërisht mekanizmat vullnetare, iniciativat vetë-rregullatore siç janë kodet etike të mediave, të cilat shtojnë përgjegjësinë e shtypit.
- h) Inkurajojë raportimin e lirë dhe pluralist të zgjedhjeve si dhe qasjen e barabartë të partive politike në mediat e shërbimit publik gjatë fushatave zgjedhore.
- i) Inkurajojë organizatat e pavarura të monitorojnë në mënyrë aktive lirinë dhe pluralizmin e mediave në vende të ndryshme.

#### **4. Promovimi dhe respektimi i të drejtave të njeriut në rrjetet kompjuterike dhe teknologjitë e komunikimit**

- 33.** Teknologjitë e informimit dhe komunikimit tani janë pjesë e jetës së përditshme dhe ofrojnë mundësi të reja për plotësimin e të drejtave njerëzore dhe për zhvillimin social dhe ekonomik. Qasja jo-diskriminuese në informata dhe liria e shprehjes për të gjithë individët, qoftë onlajn apo oflajn, duhet të sigurohet dhe të mbrohet.

BE-ja do të:

- a) Rekomandojë zbatimin e të gjitha të drejtave të njeriut, duke përfshirë lirinë e mendimit dhe shprehjes, qoftë onlajn apo oflajn.
- b) Mbështesë përpjekjet e vendeve të treta për të shtuar dhe përmirësuar për qytetarët e tyre qasjen dhe përdorimin e sigurtë të Internetit dhe komunikimit dixhital.
- c) Promovojë qasje të papenguar, të pa censuruar dhe jo-diskriminuese në Teknologjitë e Informimit dhe Komunikimit dhe shërbimeve onlajn për të gjithë, në pajtim me ligjin ndërkombëtar.
- d) Punojë kundër të gjitha orvatjeve për të bllokuar, penguar, filtruar, censuruar ose mbyllur rrjetet e komunikimit, ose çdo lloj ndërhyrjeje tjetër që shkel ligjin ndërkombëtar.
- e) Ofrojë ndihmë teknike për individët në terren për të kundërshtuar orvatjet e tilla, atëherë kur është e nevojshme
- f) Vazhdojë të punojë drejt mirëmbajtjes dhe përforcimit të modelit me shumë palë të interesuara për qeverisjen e Internetit<sup>14</sup>.

#### **5. Promovimi i përvojave më të mira nga kompanitë**

- 34.** Kompanitë e TIK luajnë rol kyç duke siguruar dhe duke bërë të mundur lirinë e shprehjes, qasjen në informata dhe privatësinë në Internet dhe përmes telekomunikimit. Ndonëse operatorët mund të ofrojnë shërbime sipas dëshirës, në pajtim me kornizën e zbatueshme ligjore, zgjedhjet e tyre ndikojnë në mënyrë të pashmangshme të drejtat e përdoruesve të tyre, sidomos kur një operator është dominant në këtë sektor. Parimet udhëzuese të OKB-së për Biznes dhe të Drejta të Njeriut theksojnë se kompanitë kanë përgjegjësi të konsiderojnë ndikimin e të drejtave të njeriut dhe të zvogëlojnë ndikimin negativ mbi të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes dhe të drejta të tjera të njeriut.

BE-ja do të:

- a) Promovojë veprimin në nivel ndërkombëtar për të zhvilluar përvojat më të mira dhe respektin për të drejtat e njeriut, në lidhje me eksportin e teknologjive që mund të përdoren për mbikqyrje ose censurë nga regjimet autoritare.
- b) Nxisë vetëdijësimin dhe pajtueshmërinë me shënimin e udhëzuesit të BE-së për kompanitë e TIK mbi biznesin dhe të drejtat e njeriut<sup>15</sup>, të hartuar nga Komisioni Evropian në bazë të Parimeve Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut.

<sup>14</sup> Siç është përcaktuar në vendimet e Këshillit në qershor 2013 mbi Strategjinë e BE-së për Sigurinë Kibernetike.

<sup>15</sup> [http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sustainable-business/files/csr-sme/csr-ict-hr-business\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sustainable-business/files/csr-sme/csr-ict-hr-business_en.pdf)


- c) Rrisë vetëdijen në mesin e gjykatësve, zyrtarëve të sundimit të ligjit, stafit të komisioneve për të drejta të njeriut dhe politikëbërësit në gjithë botën, lidhur me nevojën e promovimit të standardeve ndërkombëtare, duke përfshirë standardet e mbrojtjes së ndërmjetësuesve nga detyrimi i bllokimit të përmbajtjes të Internetit pa proces të rregullt paraprak ligjor.

#### **6. Promovojë ndryshimet ligjore dhe përvojat me synim të përforcimit të mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë onlajn/oflajn**

- 35.** Natyra globale dhe e hapur e Internetit u ofron qytetarëve mundësi të reja për këmbimin e informatave dhe mendimeve. Detyrimet e Shteteve në suaza të ligjit ndërkombëtar për të drejta të njeriut, sidomos e drejta për lirinë e shprehjes, e drejta e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave personale, shtrirja onlajn në mënyrë të njejtë si që zbatohet oflajn.
- 36.** E drejta për lirinë e shprehjes, e drejta e privatësisë dhe mbrojtja e të drejtave personale mund të vuajnë shkelje si rezultat i mbikqyrjes joligjore ose arbitrare, përgjimit të komunikimeve ose grumbullimi të të dhënave personale, sidomos kur kryhen në një shkallë masive. Shtetet duhet të sigurojnë që masat për mbrojtjen e informatave të caktuara, të mbledhura dhe të përpunuara në interes të sigurisë nacionale ose publike janë në pajtim me detyrimet e tyre në suaza të ligjit ndërkombëtar për të drejta të njeriut.

BE-ja do të:

- a) Promovojë masat për mbrojtjen e të drejtës së privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë edhe apelimin dhe mbështetjen e vendeve të treta për të sjellë legjislacionin e tyre relevant, lidhur me transparencën dhe proporcionalitetin e qasjes së qeverisë në të dhënat personale, në pajtim me ligjin ndërkombëtar për të drejta të njeriut, aty ku duhet.
- b) Promovojë dhe lehtësojë këmbimin e përvojave të mira për të siguruar që legjislacioni dhe procedurat e Shteteve që kanë të bëjnë me vëzhgimin e komunikimit dhe përgjimin dhe grumbullimin e të dhënave personale, është i bazuar në sundimin e ligjit, i nënshtruar mekanizmave të pavarur, efektivë dhe vendas të mbikqyrjes dhe të përmbushë obligimet sipas ligjit ndërkombëtar për të drejta të njeriut, përfshirë këtu parimet e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë.



*Të gjithë kanë të drejtë të kenë opinionin e tyre pa asnjë ndërhyrje. Kjo e drejtë gjithashtu përfshin të drejtën e ndryshimit të opinionit kurdo dhe për çfarëdo arsye që personi zgjedh lirshëm.*

- c) Promovojë dialogun në forumet bilaterale dhe multilaterale, duke marrë parasysh çështjen e të drejtës së privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave në epokën dixhitale, me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit dhe transparencës midis vendeve. Lidhur me çështjet e sigurisë së të dhënave dhe standardeve relevante ndërkombëtare për të drejta të njeriut.

## **C. Mjetet**

37. BE do të shfrytëzojë të gjitha instrumentet e duhura politike dhe të jashtme financiare, në mënyrë që të vazhdojë promovimin e mbrojtjes së lirisë së mendimit dhe shprehjes.

### **Dialogjet politike dhe vizitat e nivelit të lartë**

38. Në kontaktet e përshtatshme politike të nivelit të lartë, BE-ja do të hapë çështje sistematike dhe raste individuale për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe do t'u bëjë thirrje vendeve partnere që të inicojnë ndryshime legislative, për të siguruar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për lirinë e mendimit dhe shprehjes, si onlajn ashtu edhe oflajn.
39. Në dialogjet politike me vendet partnere, BE-ja do të ngrejë shkeljet serioze ose sistematike dhe kufizimet mbi të drejtën për lirinë e mendimit dhe shprehjes onlajn dhe oflajn, sipas rastit. BE-ja do t'i inkurajojë vendet partnere të ratifikojnë dhe të implementojnë instrumente relevante ndërkombëtare dhe rajonale për të drejta të njeriut. BE-ja do të inkurajojë vendet partnere që të japin ftesa për vizita të vendit për Procedurat Speciale të OKB-së për të Drejta të Njeriut, sidomos për Raportuesin Special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për liri të mendimit dhe shprehjes për vizitat e vendit, dhe të pranojnë dhe të implementojnë rekomandimet e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë edhe rekomandimet e organeve të mbikqyrjes së traktatit dhe Kontrollit Universal Periodik, si dhe ato nga Këshilli i Evropës dhe OSBE, aty ku është e rëndësishme.
40. BE-ja do të sigurojë që institucionet e BE-së dhe përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të cilët vizitojnë vendet e treta, janë plotësisht të informuar mbi gjendjen e lirisë së mendimit dhe shprehjes, qoftë onlajn apo oflajn. Vizitat e këtilla, atëherë kur është e përshtatshme, nxjerrin në pah prioritetet dhe temat e përfshira nga ky Udhërrëfyes me homologët vendorë dhe përfshijnë mbledhje me gazetarët, mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe aktorët e mediave.

### **Mbikqyrja, vlerësimi dhe raportimi mbi lirinë e shprehjes**

41. Misionet në vendet e treta (Delegacionet e BE-së, misionet CSDP dhe ambasadat e Shteteve Anëtare) si dhe zyrat qendrore do të mbikqyrin respektimin për lirinë e mendimit dhe shprehjes onlajn dhe oflajn dhe do të raportojnë mbi gjendjet shqetësuese, duke përfshirë rastet individuale dhe çështjet sistematike. Strategjitë e BE-së për të Drejta të Njeriut duhet të përfshijnë lirinë e mendimit dhe shprehjes.
42. Raportet nga Misionet e BE-së do të merren në Palët e Punës së Këshillit, dhe atëherë kur është e përshtatshme, në Komitetin Politik dhe të Sigurimit (PSC) në mënyrë që të identifikohet një përgjigje e duhur.
43. Misionet e BE-së do të inkurajojnë dhe lehtësojnë koordinimin e ngushtë dhe të rregullt dhe konsultimin me dhe mes shoqërisë ndërkombëtare dhe vendore civile, mbrojtësve për të drejta të njeriut, korrespondentët e brendshëm dhe të jashtëm dhe organet rajonale dhe të OKB-së, të cilat mbikqyrin gjendjen e lirisë së mendimit dhe shprehjes në terren, onlajn dhe oflajn. Aty ku është me rëndësi, rastet individuale do të raportohen në vazhdimësi. Aty ku është e përshtatshme, mbikqyrja e rasteve individuale mund të përfshijë vëzhgimet e proceseve gjyqësore dhe vizitat në burg.
44. Shefat e Misioneve të BE-së dhe të Shteteve Anëtare ose zyrtarët e tjerë të BE-së do të marrin parasysh publikimin e artikujve dhe dhënien e intervistave për mediat lokale, në mënyrë që të mbrojnë dhe të promovojnë lirinë e mendimit dhe shprehjes në vende të ndryshme.



## **Deklaratat Publike dhe Protestat**

45. Aty ku është e përshtatshme, BE-ja do të ndërmarrë protesta ose do të japë deklarata publike, për të parandaluar dhe për të reaguar ndaj shkeljeve të rënda ose kufizimeve mbi të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes. Shkeljet e tilla do të përfshijnë ekzekutimet, vrasjet jashtëgjyqësore, zhdukjet me forcë, arrestimet apo gjykimet arbitrare, sulmet kundër gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave, mbrojtësve për të drejta të njeriut ose individëve të tjerë, për shkak se ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e mendimit dhe shprehjes.
46. BE-ja gjithashtu do të marrë parasysh dhënien e deklaratave, si reagim ndaj zhvillimeve legjislative ose zhvillimeve të tjera relevante me ndikim të dëmshëm mbi lirinë e mendimit dhe shprehjes dhe do të promovojë përvojat më të mira.

## **Instrumentet financiare:**


47. Të gjitha instrumentet e përshtatshme të jashtme financiare të BE-së duhet të shfrytëzohen për të mbrojtur dhe promovuar edhe më tej lirinë e mendimit dhe shprehjes onlajn dhe oflajn, duke përfshirë edhe mbështetjen e paraqitjes së mediave të lira, të ndryshme dhe të pavarura. Në veçanti, BE-ja do të shfrytëzojë Instrumentin Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (EIDHR), dhe mekanizmin e tij për grante të vogla, për individët që përballen me kërcënim të menjëhershëm. Instrumentet e tjera gjeografike dhe tematike të BE-së gjithashtu do të shfrytëzohen për të promovuar lirinë e mendimit dhe shprehjes, në bashkëpunim me vendet partnere.
48. EEAS dhe shërbimet e Komisionit do të vazhdojnë të ndërtojnë veprimet ekzistuese si për shembull "Strategjinë e mos shkeljes", me qëllim të mbështesin angazhimin e BE-së, për të siguruar se Interneti dhe teknologjitë e tjera të informimit dhe komunikimit mbeten shtytës të lirisë politike, zhvillimit demokratik dhe zhvillimit ekonomik.
49. Shërbimet e EEAS dhe Komisionit Evropian, në koordinim me Shtetet Anëtare, do të ndajnë informata mbi projekte të financuara në vende të treta, në fushën e lirisë së shprehjes, për të lejuar koordinim më të mirë dhe shfrytëzim efikas të burimeve.
50. Kufizimet keqpërdoruese të lirisë së shprehjes dhe dhuna ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave duhet të merren parasysh nga BE-ja, kur merren vendime mbi suspendimin eventuale të bashkëpunimit, veçanërisht sa i përket ndihmës financiare.
51. Shërbimet e EEAS dhe Komisionit Evropian do të përfshijnë komponentet mbështetëse të mediave në ndihmën e tyre elektorale, aty ku është e përshtatshme.

## **Diplomacia publike në forumet multilaterale**

52. BE-ja do të sigurojë që liria e shprehjes të mbetet çështje e spikatur në agjendën e OKB-së, duke punuar në mënyrë aktive në të gjitha forumet e rëndësishme multilaterale, për të siguruar mbështetje të fuqishme ndër-rajonale për promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe të shprehjes onlajn dhe oflajn, duke mbështetur mandatin e Raportuesit Special të OKB-së mbi Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtës për Lirinë e Mendimit dhe Shprehjes dhe duke bashkëpunuar ngushtë me raportuesit special që kanë mandate të ngjashme nga AU, OAS, OSBE dhe OIC.
53. BE-ja do të vazhdojë të ndërtojë përmbajtjen e Rezolutave relevante të BE-së, siç është Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme mbi "Sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit", Rezoluta e Këshillit për të

Drejta të Njeriut e OKB-së mbi "Sigurinë e gazetarëve", Rezoluta mbi "Promovimin, mbrojtjen dhe gëzimin e të Drejtave të Njeriut dhe Internetit"<sup>16</sup> dhe rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi "Të drejtën e privatësisë në epokën dixhitale"<sup>17</sup>; " ; si dhe vëzhgimet relevante konkluduese të organeve mbikqyrëse të OKB-së dhe rekomandimet e raportuesve specialë për vendet e treta. Do të mbështesë dhe lehtësojë shpërndarjen e Planit të Veprimit të OKB-së për Sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit dhe do të nxjerrë mësim nga përvojat e implementimit të këtij plani (kryesisht në vendet pilote).

54. Shtetet Anëtare të BE-së do të tërheqin vëmendje, aty ku është e përshtatshme, për lirinë e shprehjes në Shqyrtimet Universale Periodike të realizuara nga Këshilli i OKB-së për të Drejta të Njeriut. Implementimi i rekomandimeve të miratuara nga shteti në shqyrtim, do të mbikqyren dhe mbështeten në mënyrë të duhur.
55. BE-ja do të intensifikojë angazhimin e vet me organizatat dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë dhe rajonalë, përfshirë këtu OKB-në (sidomos Zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejta të Njeriut (OHCHR) dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO), OSBE, Këshillin e Evropës dhe donatorët ose njësitë e tjera që mbështesin lirinë e mendimit dhe të shprehjes.
56. Shërbimet e EEAS dhe të Komisionit Evropian, në koordinim me Shtetet Anëtare, duhet të angazhohen në debate në Forumin e Qeverisjes së Internetit (IGF) dhe Samitin Botëror mbi Forumin e Shoqërisë Informative (WSIS) me qëndrimin për të promovuar një perspektivë të të drejtave të njeriut dhe një model me shumë palë të interesuara, si dhe të kultivojë vetëdijen mbi çështjet që kanë të bëjnë me lirinë e mendimit dhe shprehjes në bashkëpunim me shoqërinë civile.
57. BE-ja do të mbështesë në mënyrë aktive ditët ndërkombëtare për rritjen e vetëdijes, siç janë Dita Botërore e Lirisë së Shtypit (3 maj), Dita Ndërkombëtare për t'i dhënë fund Mosndëshkimit për krimet ndaj gazetarëve (2 nëntor), Dita Botërore kundër censurës së rrjeteve elektronike (12 mars) dhe Dita e mbrojtjes së të dhënave (28 janar).



16 A/HRC/RES/20/8 miratuar nga Këshilli për të Drejta të Njeriut më 16 korrik 2012.

17 A/C.3/68/L.45 miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, nëntor 2013

LIRIA E TË SHPREHURIT, DUKE PËRFSHIRË  
EDHE SHPREHJEN ARTISTIKE, ËSHTË  
THELBËSORE PËR ZHVILLIMIN DHE  
MANIFESTIMIN E IDENTITETIT TË  
INDIVIDËVE NË SHOQËRI.

58. BE-ja do të përsërisë rëndësinë e mediave të lira, pluraliste dhe të qëndrueshme, duke inkurajuar respektimin e rekomandimeve të Këshillit të Evropës dhe UNESCO-s, lidhur me lirinë dhe pluralizmin e mediave dhe lirinë e Internetit.

#### **Liria dhe pluralizmi i mediave dhe politika e BE-së për zgjerim**

59. BE-ja konsideron lirinë e shprehjes si prioritet për vendet candidate dhe kandidatet potenciale. Kriteret e Kopenhagës përfshijnë lirinë e shprehjes dhe pluralizmin e mediave në tërësi dhe të gjitha vendet që duan të bashkohen me Unionin duhet të demonstrojnë një angazhim të besueshëm për promovimin e lirisë së shprehjes, duke trajtuar të gjitha aspektet relevante (ligjore, rregullatore, gjyqësore, lidhur me tregun, etj.) ku pengesat e lirisë së shprehjes vazhdojnë të ekzistojnë.
60. Shërbimet e EEAS dhe Komisionit, në koordinim me Shtetet Anëtare do të mbikqyrin dhe do të ofrojnë udhëzim lidhur me çështjet e lirisë së mediave, oflajn dhe onlajn, me anë të dialogut politik para-anëtarësues dhe raporteve vjetore të progresit. Çështjet duhet të shqyrtohen në një etapë të hershme gjatë bisedave të anëtarësimit (Kapitulli 23), në mënyrë që të sigurohet kohë e mjaftueshme për progres konkret. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet luftës kundër mosndëshkimit në rastet e dhunës ndaj gazetarëve, duke krijuar një bazë transparente të tregut për sektorin e mediave dhe duke zhvilluar gjyqësinë si garancë për të drejtat individuale. BE-ja do të ndihmojë këto vende për të shqyrtuar çështjet e këtilla me anë të mbështetjes së përgjithshme teknike dhe financiare (IPA II). Ndihmë e veçantë do të ofrohet për të siguruar përforcimin e organizatave profesionale të gazetarëve dhe OJQ-ve të angazhuara për lirinë e mediave.

#### **Promovimi i mësimave të Këshillit të Evropës dhe OSBE-së**

61. BE-ja do të promovojë standardet e Këshillit të Evropës dhe angazhimet e OSBE-së për lirinë e mendimit dhe shprehjes me vendet e treta, të cilat janë anëtare të këtyre organizatave, me anë të inkurajimit të bashkëpunimit me Komitetin Drejtues mbi Mediat dhe Shoqërinë Informative (CMDSI), i cili mikëqyr punën e Këshillit të Evropës në fushën e mediave, shoqërisë informative dhe mbrojtjen e të dhënave, si dhe duke inkurajuar zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj) (në suaza të nenit 10 KEDNj) dhe zbatimin e praksës gjyqësore nga gjykatat nacionale. BE-ja gjithashtu do të mbajë kontakte të ngushta dhe do të ndërtojë sinergji me Komisionerin për të Drejta të Njeriut të Këshillit të Evropës, lidhur me

aktivitetet reciproke për të promovuar lirinë e shprehjes dhe për të shtuar sigurinë e gazetarëve. BE-ja do të promovojë lirinë e mendimit dhe shprehjes, onlajn dhe oflajn, në kontekst të OSBE-së, duke u mbështetur në angazhimet ekzistuese të OSBE-së në këtë fushë, si dhe masat e ndërtimit të OSBE-së në fushën e sigurisë kibernetike dhe duke u mbështetur në standardet e caktuara në forumet e tjera ndërkombëtare dhe rajonale.

62. Shërbimet e Shteteve Anëtare, EEAS dhe të Komisionit Evropian do të shqyrtojnë mënyra për të forcuar më tej kapacitetet dhe bashkëpunimin me Këshillin e Evropës dhe përfaqësuesin e OSBE-së për Lirinë e Mediave.

### **Masat e tregtisë**

63. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë zbatimin e duhur të Qëndrimit të Përbashkët të Këshillit 2008/944/CFSP, i cili definon rregullat e përbashkëta që qeverisin kontrollin e eksportit të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake, dhe i cili parashikon që respektimi i të drejtave të njeriut në destinacionin përfundimtar duhet të merret parasysh para se të jepen licencat e eksportit për atë vend.
64. BE-ja do të sigurojë një qasje të strukturuar dhe të vazhdueshme për kontrollin e eksportit të informatave të ndjeshme dhe të artikujve të TIK. Përveç kësaj, BE-ja do të promovojë veprime në nivel ndërkombëtar për të parandaluar shitjen e mbikqyrjes ose teknologjinë e censurës së regjimeve autoritare, duke përfshirë paraqitjen e propozimeve në kontekstin e regjimeve të rëndësishme multilaterale të kontrollit të eksportit, të tilla si Marrëveshja e Wassenaar-it.

### **Trajnimi dhe këmbimet teknike**

65. EEAS, në bashkëpunim me Komisionin dhe Shtetet Anëtare, do të hartojë material trajnues për stafin në terren dhe në shtabin kryesor. Këto materiale trajnuese do të jenë në dispozicion edhe për Shtetet Anëtare dhe institucionet e BE-së. Trajnimi do të jetë praktik në orientimin e vet, me fokus në aftësimin e misionëve të BE-së për të përdorur mjetet e BE-së për analizë dhe raportim efektiv, në mënyrë që të nxjerrë në pah prioritetet tematike të BE-së dhe të reagojë ndaj shkeljeve.
66. BE-ja do të promovojë vetëdijësimin dhe shkrim-leximin e mediave dhe internetit dhe rëndësinë e tyre në përdorimin e sigurtë dhe me përgjegjësi të Internetit, sidomos për fëmijët dhe të rinjtë, në kontekst të programeve të arsimit dhe trajnimit për të drejta të njeriut, sipas Deklaratës së OKB-së për Arsimin dhe Trajnimin mbi të Drejtat e Njeriut.
67. BE-ja do të promovojë zbatimin e udhëzuesit për kompanitë TIK/telekomunikacionit mbi biznesin dhe të drejtat e njeriut<sup>18</sup>, të hartuar nga Komisioni në bazë të Parimeve Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut.
68. EEAS, shërbimet e Komisionit Evropian dhe Shtetet Anëtare do të shqyrtojnë mënyra për të ofruar ndihmë teknike dhe për të këmbyer përvojat e mira me vendet e treta, duke përfshirë reformën legjislative për mbrojtje më të mirë të lirisë së shprehjes onlajn dhe oflajn dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të mediave. Dialogjet për të Drejtat e Njeriut dhe Konsultimet me vendet e treta gjithashtu do të përdoren për këtë qëllim.

### **Ndërtimi i kapaciteteve**

69. EAS dhe Komisioni Evropian, në koordinim me Shtetet Anëtare, do të mbështesë përpjekjet e vendeve të treta për të zhvilluar qasje të papenguar dhe të sigurt dhe përdorimin e internetit në kontekst të sigurimit të transparencës dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Mbështetje do të ofrohet për ngritjen e kapaciteteve të mbrojtësve të të drejtave të njeriut, gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias, si dhe individë që luftojnë për

---

<sup>18</sup> [http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sustainable-business/files/csr-sme/csr-ict-hrbusiness\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sustainable-business/files/csr-sme/csr-ict-hrbusiness_en.pdf)



respektimin e lirisë së shprehjes dhe të komunikimit të sigurt onlajn dhe oflajn, duke përfshirë edhe fondet nga EIDHR.

## II. IMPLEMENTIMI DHE VLERËSIMI

70. Partia Punuese e Këshillit për të Drejtat e Njeriut (PPKDNj) dhe forcat e saj për lirinë e shprehjes do të mbështesin zbatimin e këtij Udhërrëfyese që përfshin, aty ku është e përshtatshme, grupet punuese gjeografike të Këshillit. Ajo do të hartojë udhëzime shtesë për veprim, për misionet e BE-së, në veçanti lidhur me çështjet sistematike dhe rastet individuale. Ajo do të miratojë "linja për të marrë" dokumente për çështjet kyçe dhe çështjet aktuale kur është e nevojshme.
71. PPKDNj do të vlerësojë implementimin e këtij Udhërrëfyese pas një periudhe prej tre vjetësh, nëse është e përshtatshme, dhe në konsultim me shoqërinë civile, ekspertët relevantë akademikë dhe përfaqësues të mediave. Konsultimi me shoqërinë civile duhet të përfshijë mbrojtësit e të drejtave të njeriut, OJQ-të që përfshijnë të drejtat vendore dhe ndërkombëtare të njeriut, shoqatat profesionale, sektorin privat, organet ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut dhe organizatat e femrave.
72. Këmbimet e rregullta të qëndrimeve do të mbahen me komitetet përkatëse, nën-komitetet dhe grupet punuese të Parlamentit Evropian, lidhur me zbatimin, vlerësimin dhe shqyrtimin e këtij Udhërrëfyese.

## SHTOJCA 1

### A. Shembujt e veprimit që mund të shkelin ose dëmtojnë gëzimin e të drejtës për lirinë e mendimit dhe shprehjes

**Sulmet mbi një person për shkak të ushtrimit të lirisë së shprehjes:** Ekzekutimi, vrasja, zhdukja me forcë, tortura ose arrestimi arbitrar i gazetarëve ose individëve të tjerë për shkak të ushtrimit të lirisë së shprehjes përbën shkelje të nenit 19 UDHR dhe ICCPR. Aktet e tilla mund të merren nga agjentë shtetërorë ose grupe private.

**Kufizimet legislative:** Të gjitha kufizimet në lirinë e shprehjes duhet të sigurohen me ligj, mund të shqiptohen vetëm për shkaqet e përcaktuara në ligjin ndërkombëtar për të drejta të njeriut, dhe duhet të jenë në përputhje me testet e rrepta të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit.

Zbatimi i paqëndrueshëm dhe abuziv i legjisllacionit mund të përdoret për të censuruar kritika dhe për të debatuar lidhur me çështjet publike dhe për të nxitur një klimë frike dhe vetë-censurën në mesin e aktorëve të mediave dhe publikut të gjerë. Rregulloret arbitrare dhe kërkesat e akreditimit për gazetarët, mohimi i qasjes së gazetarëve, pengesat ndëshkuese ligjore për themelimin ose funksionimin e mediave dhe rregullat që lejojnë censurën e plotë ose të pjesshme, ex-ante ose post-facto dhe ndalimin e mediave të caktuara, janë shembuj të kufizimeve ligjore mbi të drejtën e lirisë së shprehjes. Kufizimet gjithashtu marrin formën e ligjeve që imponojnë taksa penguese, si dhe forma të tjera të sanksioneve ekonomike dhe kufizime të tregut.

Në internet, censura zakonisht merr formën e ligjeve që mundësojnë ndalimin e plotë ose të pjesshëm të ueb faqeve të caktuara. Në disa rrethana ekstreme, shtetet mbështeten në shkyçjen e plotë të rrjetit të internetit, duke izoluar një vend të tërë apo rajon nga pjesa tjetër e botës. Është e rëndësishme që të garantohet se qasja dhe fluksi i lirë i informatave nuk do t'u nënshtrohen kufizimeve të pajustificuara, pa marrë parasysh mediumin.


**Ligjet mbi shpifjen:** Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave, shkrimtarë, artistë, aktivistë politikë dhe mbrojtësit e tjerë të të drejtave të njeriut në gjithë botën vazhdojnë të burgosen për shpifje. Ligjet mbi shpifjen mund të shpiejnë drejt një vetë-censurimi të fuqishëm, për të shmangur frikën nga nënshtrimi në sanksione të ashpra penale apo civile. BE-ja beson se ligjet mbi shpifjen nuk duhet të keqpërdoren për të censuruar kritika dhe debate lidhur me çështjet publike.

**Thirrja abuzive e moralit publik, sigurisë apo mbrojtjes së “vlerave kombëtare”:** E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk e lejon vendosjen e kufizimeve në ushtrimin e lirisë së shprehjes, vetëm me qëllim të mbrojtjes së nocioneve të tilla si feja, kultura, shkollat e mendimit, ideologjitë apo doktrinat politike. Disa shtete bëjnë thirrje për moralin publik në mënyrë abuzive dhe si një mjet për pakësimin e të drejtave të lirisë së shprehjes. Për shembull, gratë apo grupet e grave që publikisht kritikojnë parimet diskriminuese fetare kanë qenë shënjestër e ngacmimit dhe frikësimit të rëndë, si nga shteti, ashtu edhe nga aktorët jo-shtetërorë.

**Siguria nacionale:** mbrojtja e sigurisë nacionale mund të keqpërdoret në dëm të lirisë së shprehjes. Shtetet duhet të sigurojnë që ligjet për anti-terrorizëm, ligjet e tradhëtisë ose dispozitat e ngjashme që kanë të bëjnë me sigurinë nacionale (ligjet për sekretet shtetërore, ligjet e rebelimit, etj.) hartohen dhe zbatohen në pajtim me detyrimet e tyre në suaza të ligjit ndërkombëtar për të drejta të njeriut.

**Ligjet e blasfemisë:** Ligjet që kriminalizojnë blasfeminë, kufizojnë shprehjen lidhur me fenë apo besimet e tjera; ato shpesh herë praktikohen për të përndjekur, keqtrajtuar ose frikësuar personat që i përkasin pakicave fetare ose pakicave të tjera dhe mund të kenë efekt të madh pengues mbi lirinë e shprehjes dhe lirinë e fesë apo besimit. BE-ja rekomandon dekriminalizimin e veprave të tilla dhe është kundër dënimit me vdekje, dënimit fizik, apo privimin nga liria si dënim për blasfemi. BE-ja do të vazhdojë të punojë dhe do të mbështesë organizatat që mbështesin heqjen e ligjeve të blasfemisë.

**“Gjuha e urrejtjes”:** në të drejtën ndërkombëtare nuk ekziston asnjë definicion i pranuar universal i termit “gjuha e urrejtjes”. Termi përdoret zakonisht për t’iu referuar shprehjeve abuzive, ofenduese, frikësuese ose ngacmuese që nxit dhunë, urrejtje ose diskriminim kundër individëve ose grupeve të identifikuar sipas këtyre karakteristikave. Sipas të drejtës ndërkombëtare, nga shtetet kërkohet që të ndalojnë format më



**LIRIA E TË MENDUARIT DHE TË SHPREHURIT MË TEJ PËRFSHIN LIRINË PËR TË SHPREHUR DHE KOMUNIKUAR TË GJITHA LLOJET E INFORMATAVE DHE IDEVE. INFORMATAT OSE IDETË QË MUND TË KONSIDEROHEN SI KRITIKE OSE KONTROVERSE NGA AUTORITETET OSE NGA NJË PJESË E MADHE E POPULLATËS.**

të rënda të gjuhës së urrejtjes, siç është përkrahja e urrejtjes nacionale, racore apo fetare e cila përmban nxitje të diskriminimit, armiqësisë apo dhunës (Neni 20.2 ICCPR dhe neni 4 CERD). Legjislacioni i gjuhës së urrejtjes nuk duhet të keqpërdoret nga qeveritë, për të dekurajuar qytetarët nga angazhimi në debate legjitime demokratike mbi çështje të interesit të përgjithshëm.

Në kontekst të Evropës, praktika ligjore ECHR bën dallim mes nxitjes së vërtetë dhe serioze të ekstremizmit në njerën anë, dhe të drejtën e individëve (përfshirë gazetarët dhe politikanët) për të shprehur qëndrimet e tyre lirshëm dhe "ofendojnë, shokojnë apo shqetësojnë". Në pajtim me praksën ligjore të GJEDNj, Vendimi i Kornizës së BE-së për luftimin e formave të caktuara dhe shprehjes së racizmit dhe ksenofobisë të caktuara me të drejtën penale<sup>19</sup> përcakton se Shtetet Anëtare do të dënojnë nxitjen e qëllimshme publike të dhunës ose urrejtjes, si dhe përkrahjen publike, mohimin ose trivializimin e krimeve të caktuara ndërkombëtare, kur ato bëhen në mënyrë që ka gjasa të nxisin dhunë ose urrejtje.

**Kufizimet që kanë të bëjnë me lirinë dhe pluralizmin e mediave:** Mungesa e lirisë dhe pluralizmit të mediave mund të pengojë lirinë për të marrë dhe për të dhënë informata, gjë që nga ana tjetër destabilizon besimin publik në media dhe ushtrimin e vetë demokracisë. Për më tepër, mungesa e lirisë dhe pluralizmit të mediave zvogëlon aftësinë e mediave për të vepruar si mbikqyrës që mban pushtetin e llogarisë.

Gjithashtu, duhet thënë se liria e shprehjes është e lidhur ngushtë me strukturën e financimit duke bërë të mundur një pavarësi të vërtetë si për mediat publike ashtu edhe për ato private. Tregjet e drejta dhe të pavarura të mediave janë të domosdoshme për realizimin e të drejtës për shprehjen e lirë. Aktiviteti Rregullator nuk duhet të përdoret për të formësuar mediat sipas shijes së grupeve të caktuara të interesit apo kandidatëve në pushtet, me përjashtim të grupeve ose pozicioneve të tjera nga debati publik.

**Mungesa e pavarësisë së organeve rregullatore:** Pavarësia e organeve rregullatore nga ndikimi qeveritar është një kusht jetik për funksionimin e mediave të lira dhe të pavarura. Procedurat e propozimit dhe emërimit për të gjithë anëtarët e organeve rregullatore duhet të ndjekin rregullat e projektuara për mbrojtjen e pavarësisë



<sup>19</sup> <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:328:0055:0058:EN:PDF>

dhe objektivitetit të tyre. Organet rregullatore nacionale nuk duhet të kenë ndërhyrje direkte politike dhe duhet të kenë një detyrim pozitiv për të mbrojtur të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe lirinë e shprehjes.

**Kufizimet e Internetit nga operatorët:** : Përmbajtja specifike, aplikacionet ose shërbimet nuk duhet të bllokohen asnjëherë, ngadalësohen, degradohen ose diskriminohen, përveç në raste shumë të rralla (p.sh. implementim i një vendimi të gjykatës ose një dispozite ligjore, për shembull konform dispozitave të zbatimit të ligjit për abuzimin e fëmijëve<sup>20</sup>, çështjet thelbësore të sigurisë së rrjetit, parandalim i një komunikimi të pajustificuar, zvogëlim i dyndjes së jashtëzakonshme). Ndërhyrja mund të lind nga zbatimi abuziv, oportunist ose diskriminues (gjeometri e ndryshueshme) i ligjeve të ndryshme, ndërhyrja në platformat ose aplikacionet private që operojnë në bazë të internetit, etj. Bllokimi i sinjaleve pa tel është një mjet tjetër censurimi, i cili privon individët nga e drejta e tyre për lirinë e shprehjes.

**Kufizimet mbi të drejtën e qasjes në informata:** Raportuesi Special i OKB-së për Lirinë e Shprehjes rekomandon që parlamentet të miratojnë legjislacionin për qasje në informatat publike, në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare, duke nënvizuar se në të gjitha shoqëritë demokratike, transparenca e aktiviteteve publike luan një rol vendimtar për besimin e popullatës.

**Kufizimi i lirisë së shprehjes për mbrojtjen e të drejtave të pronës intelektuale:** Bllokimi i qasjes në faqet e internetit për shkak të mbrojtjes së të drejtave të autorit mund të përbëjë një kufizim joproporcional të lirisë së mendimit dhe të shprehjes. Çdo kufizim duhet të përputhet me testin kumulativ tre pjesësh, i cili përcaktohet në paragrafin 20 të këtij Udhërrefyesi.

**Kufizimet e të drejtës për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave:** Mbikqyrja e paligjshme e komunikimeve, përgjimi i tyre, si dhe mbledhja e paligjshme e të dhënave personale shkel të drejtën e privatësisë dhe lirinë e mendimit pa ndërhyrje dhe mund të çojë drejt kufizimeve të lirisë së shprehjes. Ndërhyrjet e paligjshme në jetën private të individëve mund të kufizojnë në mënyrë direkte dhe indirekte zhvillimin dhe shkëmbimin e lirë të ideve. Për shembull, kufizimet e anonimitetit në komunikim, mund të dekurajojnë viktimat e të gjitha formave të dhunës të raportojnë abuzimet ndaj tyre, nga frika e viktimizimit të dyfishtë. Lidhur me këtë, Neni 17 i ICCPR-së i referohet direkt mbrojtjes nga ndërhyrjet me "korrespondencë", një term që duhet të interpretohet për të përfshirë të gjitha format e komunikimit, si onlajn ashtu edhe oflajn.

Qasja e paligjshme ose arbitrare private apo qeveritare në të dhënat personale mund të ketë ndikim negativ mbi lirinë e shprehjes, meqenëse nuk ka shumë gjasa që individët të përdorin teknologjitë elektronike të komunikimit.

---

<sup>20</sup> Shih Protokolin Opcional të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve




Lista e pashterrshme e normave, standardeve, parimeve dhe burimeve ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me lirinë e mendimit dhe shprehjes, në të cilat mund të thirret ose t'i përdorë BE-ja në kontakt me vendet e treta.

### 1. 1. Deklarata Universale për të Drejta të Njeriut

**Neni 19:** "Të gjithë kanë të drejtë të lirisë së mendimit dhe shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje dhe lirinë për të kërkuar, pranuar dhe komunikuar informata dhe ide përmes të gjitha mediave dhe pa marrë parasysh kufijtë".

### 2. Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike

**Neni 19:** "Të gjithë do të kenë të drejtën të kenë mendimin e vet pa ndërhyrje. Të gjithë do të kenë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë do të përfshijë lirinë për të kërkuar, pranuar dhe komunikuar informata dhe ide të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë gojarisht, me shkrim ose në formë të shtypur, në formë të artit, ose përmes mediumeve të preferuara të tij apo të saj. Ushtrimi i të drejtave të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni përmban në vete detyrime dhe përgjegjësi të veçanta. Prandaj, mund t'u nënshtrohet kufizimeve të caktuara, mirëpo këto do të jenë vetëm sipas përcaktimit me ligj dhe janë të nevojshme për: (a) Respektimin e të drejtave ose reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë nacionale ose rendit publik, shëndetit publik ose parimeve morale."



**Liria e të menduarit dhe të shprehurit janë themelore për plotësimin dhe gëzimin e një game të gjerë të të drejtave të njeriut, duke përfshirë lirinë e shoqërimit dhe tubimit, lirinë e të menduarit, fesë ose besimit, të drejtën e arsimit, të drejtën për të marrë pjesë në jetë kulturore, e drejta e votimit dhe të gjitha të drejtat tjera politike që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në çështjet publike.**

<sup>21</sup> Ky Udhërrëfyes bazohet në standardet ndërkombëtare dhe rajonale për lirinë e shprehjes. Ka një numër i vendeve që nuk kanë nënshkruar dhe as nuk kanë ratifikuar Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejta Civile dhe Politike apo traktate të tjera të rëndësishme për të drejta të njeriut, kurse standardet e zhvilluara në kuadër të këtyre traktateve nuk janë zyrtarisht të detyrueshme për ata. Jurisprudenca e organeve ndërkombëtare dhe rajonale për të drejta të njeriut, si dhe tekste/dokumentet jo-detyruese dhe standardet e tjera, ilustron mënyrën në të cilën janë interpretuar garancitë ndërkombëtare dhe kushtetuese të lirisë së shprehjes. Kështu, ato paraqesin prova autoritare për kuptimin e përgjithshëm të fushëveprimit dhe natyrës të të gjitha garancive ndërkombëtare të lirisë së shprehjes. Ato gjithashtu ofrojnë udhëzime të forta lidhur me interpretimin e garancive të lirisë së shprehjes për të gjitha shtetet. Për më tepër, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut konsiderohet se ka fituar fuqi ligjore si e drejta ndërkombëtare zakonore.

**Neni 18:** *“Të gjithë do të kenë të drejtën e lirisë së mendimit, vetëdijes dhe fesë.*

*Kjo e drejtë do të përfshijë lirinë për të pasur dhe përvetësuar një fe ose besim të preferuar, dhe lirinë individuale ose të komunitetit me të tjerët në mënyrë publike ose private, për të manifestuar fenë ose besimin e tij me adhurim, respektim, në praktikë ose në mësim. Askush nuk do t'i nënshtrohet shtrëngimit që do të pengojë lirinë e tij për të pasur apo përvetësuar një fe apo besim të preferuar. Liria e manifestimit të fesë apo besimit mund t'i nënshtrohet vetëm kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, rendin, shëndetin ose parimet morale publike, ose të drejtat fundamentale dhe liritë e të tjerëve. Pjesëmarrësit e kësaj Marrëveshjeje marrin përsipër të respektojnë lirinë e prindërve dhe sipas rastit, kujdestarëve ligjorë për të siguruar arsimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre, në pajtim me bindjet e tyre.”*

**Neni 17:** *“Askush nuk do t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare ose joligjore në privatësi, familje, shtëpi apo komunikim, as edhe sulmeve të paligjshme ndaj nderit dhe prestigjit personal. Gjithkush ka të drejtë të mbrohet me ligj nga ndërhyrjet apo sulmet e tilla.”*

**Neni 20.2:** *“Shtetet duhet të ndalojnë me ligj “çdo lloj përkrahjeje të urrejtjes nacionale, racore apo fetare, e cila përmban nxitje të diskriminimit, armiqësisë apo dhunës.”*

### **3. Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor**

**Neni 4:** *“Shtetet pjesëmarrëse dënojnë propagandën dhe të gjitha organizatat që bazohen në idetë ose teoritë e superioritetit të një race ose grupi personash të një ngjyre ose origjine etnike, apo të cilat përpiqen të justifikojnë apo të nxisin urrejtjen racore dhe diskriminimin në çdo formë, dhe angazhohen në ndërmarrjen e masave të menjëhershme dhe pozitive që janë projektuar për të çrrënjësuar të gjitha nxitjet ose aktet e diskriminimit të tillë dhe, për këtë qëllim, duke pasur parasysh parimet e mishëruara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe të drejtave të përcaktuara në nenin 5 të kësaj Konvente, ndër të tjera: (a) Do të deklarojë si vepër penale të dënueshme me ligj të gjitha shpërndarjet e ideve të bazuara në epërsinë racore ose urrejtje, nxitjet e diskriminimit racor, si dhe të gjitha aktet e dhunës ose nxitjet për aktet e tilla ndaj çdo race ose grupi personash të një ngjyre tjetër ose origjine tjetër etnike, si dhe dhënia e ndihmës për aktivitetet raciste, duke përfshirë financimin e tyre; (B) Do të denoncojë dhe ndalojë organizatat e paligjshme, si dhe propagandën e organizuar dhe të gjitha aktivitetet e tjera propaganduese, të cilat promovojnë dhe nxisin diskriminimin racor, dhe do të njohin pjesëmarrjen në organizata ose veprimtari të tilla si vepër penale të dënueshme me ligj; (C) Nuk do të lejojnë autoritetet ose institucionet publike, nacionale ose lokale që të nxisin ose të inkurajojnë diskriminimin racor.”*

### **4. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës<sup>22</sup>**

**Neni 13:** *“Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë do të përfshijë lirinë për të kërkuar, pranuar dhe komunikuar informata dhe ide të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë gojarisht, me shkrim apo në formë të shtypur, në formë të artit, ose me anë të ndonjë mediumi tjetër të preferuar të fëmijës. Ushtrimi i kësaj të drejte mund t'u nënshtrohet kufizimeve të caktuara, por këto do të jenë të tilla që përcaktohen me ligj dhe janë të domosdoshme: (a) Për respektimin e të drejtave ose prestigjit të të tjerëve; ose (b) Për mbrojtjen e sigurisë nacionale apo rendit publik, ose të shëndetit apo moralit publik.*

### **5. Konventa mbi Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit**

### **6. Deklarata e OKB-së për Arsim dhe Trajnim për të Drejtat e Njeriut**

### **7. Deklarata e OKB-së për të drejtat e personave që u përkasin pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore**

### **8. Deklarata e OKB-së për të drejtat e popujve indigjenë (Neni 16)**

---

<sup>22</sup> Të rëndësishëm janë edhe nenet 15 (mbi të drejtën për lirinë e shoqërimit dhe tubimit), 16 (mbrojtja më e mirë e të drejtës së mendimit) dhe 17 (mbi qasjen e fëmijës në informata dhe materiale të mediave).

**9. Raportuesi Special i OKB-së për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për Lirinë e Mendimit dhe Shprehjes**

Zyra e Raportuesit Special të OKB-së për Lirinë e Mendimit dhe Shprehjes u themelua me rezolutën e Komisionit të OKB-së për të Drejta të Njeriut në vitin 1993<sup>23</sup>.

**10. Plani i Veprimit Rabat për ndalimin e përkrahjes së urrejtjes nacionale, racore ose fetare që përmban nxitjen e diskriminimit, armiqësisë apo dhunës – 2012**

**11. UNESCO: Deklarata të zgjedhura, Vendime dhe Dokumente Strategjike**

- Kushtetuta e UNESCO-s (Neni I.2.a - 1945)
- Deklarata Windhoek për promovimin e shtypit të pavarur dhe pluralist afrikan (Namibia 1991)
- Rezoluta e UNESCO-s 29 mbi Dënimin e Dhunës ndaj Gazetarëve (1997)
- Deklarata e Beogradit për mbështetjen e mediave gjatë konfliktit të dhunshëm dhe vendet në tranzicion
- Deklarata Maputo mbi nxitjen e lirisë së shprehjes, qasjen në informata dhe fuqizimin e popullit (2008)
- Deklarata Brisbane mbi Lirinë e Informimit: E drejta për të ditur (2010)
- Deklarata e Uashingtonit mbi mediat e shekullit 21: Kufijtë e rinj, barrierat e reja (2011)
- Deklarata Carthage mbi Lirinë e Shtypit dhe Sigurinë e Gazetarëve (2012)
- Plani i Punës i UNESCO-s për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit (2013)
- Plani i Veprimit i OKB-së mbi sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit (2012)
- Strategjia e Implementimit 2013-2014 – Plani i Veprimit i OKB-së për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit.
- Deklarata e San Jose-së mbi Lirinë e të folurit: Sigurimi i lirisë së shprehjes në të gjitha mediat (2013)
- Deklarata e fundit e WSIS të parë + 10 Evenimente shqyrtuese (2013)

E DREJTA PËR LIRINË E TË SHPREHURIT PËRFESHIN

LIRINË PËR TË KËRKUAR DHE PRANUAR **INFORMATA.**

KJO E DREJTË ËSHTË PËRBËRËSI KRYESOR I QEVERISJES **DEMOKRATIKE.**

<sup>23</sup> <http://www.ohchr.org/EN/ISSUES/FREEDOMOPINION/Pages/OpinionIndex.aspx>

## Mjetet

- Treguesit e Zhvillimit të Mediave (MDIs) (2006)
- Treguesit e Sigurisë së Gazetarëve: (2013)
- Treguesit e ndjeshmërisë gjinore për Mediat (GSIM) (2012)
- Mjetet e lirisë së shprehjes (2013)

## Liria e shprehjes dhe të drejtat e ngajshme në instrumentet rajonale

### 12. Këshilli i Evropës<sup>24</sup>:

- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale

**(Neni 8 – E drejta e respektit për jetën private dhe familjare)** *“Të gjithë kanë të drejtë të respektit për jetën e tyre private dhe familjare, shtëpinë dhe komunikimin e tyre. Nuk do të ketë asnjë ndërhyrje nga ndonjë autoritet publik me ushtrim të kësaj të drejte, përveç nëse kjo është në pajtim me ligjin dhe është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë nacionale, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e trazirave apo krimin, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”.*

**(Neni 9 – Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë)** *“Gjithkush ka të drejtë për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të fesë apo besimit, qoftë vetëm ose në komunitet me të tjerë dhe në mënyrë publike apo private, në adhurim, mësimdhënie praktikë dhe ceremoni fetare”. “Liria për të manifestuar fenë ose bindjet do t’u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë përcaktuar me ligj dhe janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike në interesin e sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit publik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”.*

**(Neni 10 – Liria e shprehjes)** *“Të gjithë kanë të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë do të përfshijë lirinë e mendimit pa ndërhyrje dhe pranimin dhe komunikimin e informatave dhe ideve pa ndërhyrje nga autoritete publike dhe pavarësisht nga kufijtë. Ky nen nuk do t’i ndalojë shtetet të kërkojnë licenca për ndërmarrje të transmetimit, televizive apo kinema. Meqenëse përmban detyrime dhe përgjegjësi, ushtrimi i këtyre të drejtave mund t’u nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të përcaktuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë nacionale, integritetit territorial ose sigurisë publike, për parandalimin e trazirave apo krimin, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit publik, për mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të personave të tjerë, për parandalimin e zbulimit të informatave të pranuar konfidenciale ose për ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjykatave”.*

**(Neni 17 – Ndalimi i keqpërdorimit të të drejtave)** *“Asgjë në këtë Konventë nuk mund të interpretohet si e drejtë e një shteti, grupi apo personi për t’u angazhuar në ndonjë aktivitet apo për të kryer ndonjë akt që synon shkatërrimin e ndonjë prej të drejtave dhe lirive të caktuara në këtë Konventë ose kufizimin e tyre në masë më të madhe se sa që është përcaktuar në Konventë”.*

---

<sup>24</sup> Instrumentet, konventat, rekomandimet, deklaratat e Këshillit të Evropës, duke përfshirë dokumentet shumë të rëndësishme të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mund t’i gjeni në: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1835645>




- **Konventa për mbrojtjen e individëve për sa i përket përpunimit automatik të të dhënave personale (Konventa 108)**

**Neni 1:** Objekti dhe qëllimi. Qëllimi i kësaj konvente është të sigurojë në territorin e secilës palë për çdo individ, pavarësisht nga kombësia apo vendbanimi i tij, respektimi i të drejtave të tij dhe lirive themelore, dhe në veçanti e drejta e tij për jetën private, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale që kanë të bëjnë me atë ("mbrojtja e të dhënave").

- **Konventa Kornizë për mbrojtjen e Pakicave Nacionale dhe Raporti Sqarues (Neni 9)**
- **Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave (Neni 11 mbi mediat)**

Këshilli i Evropës aktualisht është duke punuar mbi standardet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e gazetarëve, duke përfshirë detyrimet pozitive të shteteve anëtare. Ky është prioritet gjatë Kryesisë aktuale të Austrisë në Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës, duke pasur parasysh edhe Rezolutën e fundit 3 të titulluar "Siguria e Gazetarëve", e miratuar nga Këshilli i Ministrave të Evropës, përgjegjës për Mediat dhe Shoqërinë Informative, e cila u mbajt në Beograd më 7 dhe 8 nëntor 2013.<sup>25</sup>

- UNESCO (zyrtarët e lartë) kanë kërkuar nga Këshilli i Evropës të marrin parasysh sigurinë e gazetarëve si një tregues të brishtësisë shtetërore. Duke marrë parasysh se dhuna ndaj gazetarëve mbizotëron në mungesë të lirisë së shprehjes, siguria e gazetarëve mund të jetë vërtetë një tregues i vlerës së lartë të respektimit të lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave në një komunitet të caktuar<sup>26</sup>.
- Puna e Këshillit të Evropës për lirinë e Internetit, plotësisht në përputhje me Konventën ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventën e të drejtave të njeriut përmes Strategjisë së vet për Qeverisje të Internetit 2012- të 2015, promovon angazhimin e 47 anëtarëve për të mos dëmtuar Internetin dhe standardet e ndryshme të filtrimit dhe bllokimit, neutralitetit të rrjetit, dhe aspekte të të drejtave të njeriut në veprimin e aktorëve të ndryshëm të internetit.



<sup>25</sup> [http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/Belgrade2013/Belgrade%20Ministerial%20Conference%20Texts%20Adopted\\_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/Belgrade2013/Belgrade%20Ministerial%20Conference%20Texts%20Adopted_en.pdf)

<sup>26</sup> Për këtë ekzistojnë standarde specifike të Këshillit të Evropës: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=419411>  
<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1207243&Site=CM&BackColorInternet=9999CC&BackColorIntranet=FFBB55&BackColorLogged=FFAC75>  
[http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/cm/rec\(1997\)020&expmem\\_EN.asp](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/cm/rec(1997)020&expmem_EN.asp)



- Praktika gjyqësore e ECHR ka vendosur parametra të caktuar për të përshkruar “gjuhën e urrejtjes” me zbatim të nenit 17 (ndalimi i keqpërdorimit të të drejtave) të Konventës, ku komentet në fjalë përmbajnë gjuhën e urrejtjes dhe mohojnë vlerat themelore të Konventës, ose (b) duke zbatuar kufizimet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 10 dhe nenit 11 të Konventës (kjo qasje është miratuar ku gjuha e caktuar, edhe pse është gjuha e urrejtjes, nuk ka prirje për të shkatërruar vlerat themelore të Konventës)<sup>27</sup>.
- **Rekomandimi CM/Rec (2011)7<sup>28</sup>** i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare, përmban një nocion të gjerë të Mediave që përfshijnë të gjithë aktorët e inkuadruar në prodhimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve, duke përfshirë informatat, analizat, komentet dhe mendimet, për një numër potencialisht të madh të njerëzve. Komiteti i Ministrave gjithashtu pranon se, për qëllime të caktuara, disa privilegje të cilat janë të njohura zakonisht për gazetarët mund t’u jepen edhe aktorëve të tjerë, të cilët nuk mund të kualifikohen plotësisht si media (për shembull bllogjerët individualë) duke marrë parasysh shkallën në të cilën aktorët e tillë mund të konsiderohen si pjesë e ekosistemit të mediave dhe të kontribuojnë në funksionet dhe rolin e mediave në një shoqëri demokratike. Referenca gjithashtu mund të bëhen për Rezolutën 1 të titulluar “Liria e internetit”, e cila u miratua në Konferencën Ministrore të Këshillit të Evropës, e cila u mbajt në Beograd të Serbisë, më 7 dhe 8 nëntor 2013.

### 13. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Acquis e OSBE-së përfshin disa dispozita mbi lirinë e shprehjes, midis të tjerash:

- **Dokumentin e Mbledhjes së Kopenhagës për Konferencën e Dimensionit Njerëzor të CSCE (1990):**

*(9. Shtetet pjesëmarrëse riafirmojnë se: gjithkush ka të drejtën e lirisë së shprehjes, duke përfshirë të drejtën e komunikimit. Kjo e drejtë do të përfshijë lirinë e mendimit dhe lirinë për të pranuar dhe komunikuar informata dhe ide pa ndërhyrje nga autoritete publike dhe pa amrrë parasysh kufijtë. Ushtrimi i kësaj të drejte mund t’u nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe të cilat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në veçanti, nuk do të vendosen kufizime mbi qasjen dhe përdorimin e mjeteve për riprodhimin e dokumenteve të ndryshme, duke respektuar të drejtat që kanë të bëjnë me pronësinë intelektuale.*

- **Dokumenti i Budapestit: Drejt një Partneriteti të Vërtetë në një epokë të re (Samiti i Shefave të Shteteve, 1994):**

*36. Shtetet pjesëmarrëse riafirmojnë se liria e shprehjes është e drejtë fundamentale dhe një element themelor i shoqërisë demokratike. Në këtë drejtim, mediat e pavarura dhe pluraliste janë thelbësore për një shoqëri të lirë dhe të hapur dhe për sistemet qeveritare me përgjegjësi. Ato marrin këtë parim udhëzues për të ruajtur këtë të drejtë.*

- **Vendimi i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 633, shtojcë e Vendimit 12/04 të Mbledhjes së Dymbëdhjetë të Këshillit Ministror (Sofje, 2004):**

*Riafirmim i rëndësisë së respektimit të plotë të të drejtës për lirinë e mendimit dhe shprehjes, ku përfshihet liria për të kërkuar, pranuar dhe komunikuar informata, të cilat janë thelbësore për demokracinë dhe në fakt përforcohen nga Interneti.*

<sup>27</sup> *Handyside v. the United Kingdom, 7 December 1976, Erbakan v. Turkey, judgment of 6 July 2006, Vona v. Hungary 9 July 2013, Aksu v. Turkey 15 March 2012 (Grand Chamber), Fïret v. Belgium 16 July 2009, Leroy v. France 2 October 2008, Jersild v. Denmark 23 September 1994, Hizb Ut-Tahrir and Others v. Germany 19 June 2012 (decision on the admissibility), Garaudy v. France, judgment of 24 June 2003.*

<sup>28</sup> <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1835645>

- **Udhërrëfytyesi i OSBE-së mbi përdorimin e gjuhëve të pakicave në mediat elektronike (2003)**

- Zyra e **Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave** mbetet institucioni i vetëm botëror ndër-qeveritar që ka mandate për të mbrojtur dhe promovuar lirinë e mediave në 57 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Kjo zyrë u themelua në vitin 1997. Në mars 2010, Dunja Mijatovic nga Bosnja dhe Hercegovina u emërua Përfaqësuese.<sup>29</sup>

#### 14. Unioni Afrikan:

- **Karta afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve**

**Neni 9:** *“Çdo person ka të drejtë të marrë informata. Çdo person do të ketë të drejtë të shprehë dhe të shpërndajë mendimet e tij në kuadër të ligjit.”*

Raportuese Speciale për Lirinë e Shprehjes dhe Qasjen në informata në Afrikë është zj. Faith Pansy Tlakula.

#### 15. Organizata e Shteteve Amerikane (OAS)

- **Konventa Amerikane e të Drejtave të Njeriut**

**Neni 13:** *“Gjithkush ka të drejtën për lirinë e mendimit dhe shprehjes. Kjo e drejtë përfshin të drejtën për të kërkuar, pranuar dhe për të komunikuar informatat dhe idetë e të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë gojarisht, me shkrim ose në formë të shtypur, në formë arti, ose me anë të ndonjë mediumi të tij të preferuar. Ushtrimi i të drejtës së përcaktuar në paragrafin paraprirës nuk do t’i nënshtrohet censurës paraprake mirëpo do t’i nënshtrohet imponimit të mëvonshëm të përgjegjësisë, i cili do të përcaktohet me ligj në masën e nevojshme për të siguruar: a. Respektimin e të drejtave ose reputacionit të të tjerëve; ose b. Mbrojtjen e sigurisë nacionale, rendit publik ose shëndetit apo moralit publik. E drejta e shprehjes nuk mund të kufizohet me metoda apo mjete indirekte, të tilla si keqpërdorimi i pushtetit ose kontrolli privat i gazetave, frekuencave të radio transmetimit ose paisjeve të përdorura në shpërndarjen e informatave, ose me çdo mjet tjetër që synon të pengojë komunikimin dhe qarkullimin e ideve dhe qëndrimeve. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2 më sipër, argëtimet publike mund t’i nënshtrohen me ligj censurës paraprake për të vetmin qëllim të rregullimit të qasjes për mbrojtjen morale të fëmijërisë dhe adoleshencës. Çdo propagandë për luftë dhe çdo përkrahje e urrejtjes nacionale, racore ose fetare që përbën nxitjen e dhunës së paligjshme ose përkrahje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm ndaj ndonjë personi apo grupi personash në çdo bazë, duke përfshirë ato racore, tw ngjyrës, fesë, gjuhës ose origjinës nacionale do të konsiderohen si vepra të dënueshme me ligj.*

Raportuesi Special i OShA (Organizata e Shteteve Amerikane) mbi Lirinë e Shprehjes, u krijua nga Komisioni ndër-Amerikan mbi të Drejtat e Njeriut në tetor 1997. Raportuese special e OShA është Catalina.

---

<sup>29</sup> <http://www.osce.org/fom/31230>

## 16. ASEAN

- **Deklarata e të Drejtave të Njeriut<sup>30</sup>:**

**Neni 23:** “Çdo person ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes, duke përfshirë lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe për të kërkuar, marrë dhe komunikuar, qoftë me gojë, me shkrim ose përmes ndonjë mediumi tjetër të preferuar të atij personi”.

### **Bashkimi Evropian:**

- **Traktati mbi funksionimin e Bashkimit Evropian**

#### **Neni 16**

1. Të gjithë kanë të drejtën e mbrojtjes së të dhënave të tyre personale.
2. Parlamenti Evropian dhe Këshilli, duke vepruar në pajtim me procedurën e rregullt legjislativë, do të përcaktojnë rregullat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e individëve, lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Unionit dhe nga Shtetet Anëtare, gjatë realizimit të aktiviteteve që përkasin në fushëveprimin e të drejtës së Unionit, dhe rregullat që kanë të bëjnë me lëvizjen e lirë të të dhënave të këtyre. Respektimi i këtyre rregullave do t'i nënshtrohet kontrollit të autoriteteve të pavarura. Rregullat e miratuara në bazë të këtij Neni do të jenë pa paragjykim ndaj rregullave specifike të përcaktuara në Nenin 39 të Traktatit për Bashkimin Evropian.

- **Karta e të Drejtave Fundamentale e Bashkimit Evropian**

**Neni 7:** Respekti për jetën private dhe familjare

“Të gjithë kanë të drejtën e respektimit të jetës së tyre private dhe familjare, shtëpisë dhe komunikimit”.

**Neni 8:** Mbrojtja e të dhënave personale

“Të gjithë kanë të drejtën e mbrojtjes së të dhënave të tyre personale. Të dhënat e tilla duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë për qëllime të specifikuar dhe në bazë të pëlqimit të personit në fjalë ose ndonjë baze tjetër legjitime të caktuar me ligj. Të gjithë kanë të drejtë të qasjes në të dhënat e grumbulluar kundër tyre, dhe të drejtën e korigjimit të tyre”. “Përputhja me këto rregulla do t'i nënshtrohet kontrollit të ndonjë autoriteti të pavarur”.

**Neni 10:** Liria e të menduarit, vetëdijes dhe fesë

“Të gjithë kanë të drejtën e lirisë së të menduarit, vetëdijes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të fesë ose besimit dhe lirinë që vetëm ose në komunitet me të tjerë, publikisht ose në mënyrë private, të manifestojë fenë ose besimin, me anë të adhurimit, mësimit, praktikimit dhe ceremonisë fetare. E drejta e kundërshtimit të ndërgjegjshëm është e njohur, në pajtim me ligjet nacionale që administrojnë ushtrimin e kësaj të drejte.”

---

<sup>30</sup> <http://www.asean.org/news/asean-statement-communiqués/item/asean-human-rights-declaration>

**MEDIAT E LIRA, TË SHUMËLLOJSHME DHE  
TË PAVARURA JANË THELBËSORE NË ÇDO  
SHOQËRI, PËR TË PROMOVIUAR DHE  
MBROJTUR TË DREJTËN E TË MENDUARIT  
DHE TË SHPREHURIT DHE TË DREJTAT E  
TJERA TË NJERIT.**



#### **Neni 11:** Liria e shprehjes dhe informimit

“Të gjithë kanë të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë do të përfshijë lirinë e mendimit, si dhe pranimit dhe komunikimit të informatave dhe ideve pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pavarësisht nga kufijtë. Liria dhe pluralizmi i mediave do të respektohen”.

#### **Neni 22**

Shumëllojshmëria kulturore, fetare dhe gjuhësore - “Unioni do të respektojë shumëllojshmërinë kulturore, fetare dhe linguistike.”

#### **Instrumentet e BE-së mbi shprehjen e urrejtjes:**

- **Vendimi Kornizë 2008/913/JHA mbi luftimin e formave dhe shprehjeve të ndryshme të racizmit dhe ksenofobisë me anë të të drejtës penale.**

**Neni 1: Kundërvajtjet që kanë të bëjnë me racizmin dhe ksenofobinë** Çdo Shtet Anëtar do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që sjelljet e qëllimshme, në vijim, të dënohen:

- a) nxitje publike e dhunës ose urrejtjes kundër një grupi njerëzish ose një përfaqësuesi të një grupi të tillë duke iu referuar racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes ose origjinës nacionale apo etnike;
- b) kryerje e një akti të referuar në pikën (a) me anë të shpërndarjes publike ose distribuimit të trakteve, fotografive ose materialeve të tjera;
- c) falje publike, mohim ose trivializim i krimeve të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës sipas definicionit në nenet 6, 7 dhe 8 të Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, drejtuar kundër një grupi personash apo një anëtar të një grupi të tillë duke iu referuar racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes ose origjinës nacionale apo etnike kur kjo sjellje është bërë në mënyrë e cila mund të nxisë dhunën ose urrejtjen ndaj një grupi apo anëtarë të një grupi të tillë;

d) falje publike, mohim ose trivializim i krimeve të definuara në nenin 6 të Kartës së Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak, të shtuar në Marrëveshjen e Londrës më 8 gusht 1945, drejtuar kundër një grupi personash apo një anëtari të një grupi të tillë duke iu referuar racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes ose origjinës nacionale apo etnike kur kjo sjelle është bërë në mënyrë e cila mund të nxisë dhunën ose urrejtjen ndaj një grupi apo anëtarë të një grupi të tillë.

**Neni 7:** “Ky Vendim Kornizë nuk do të ketë efektin e modifikimit të obligimit për të respektuar të drejtat fundamentale dhe parimet ligjore fundamentale, përfshirë këtu lirinë e shprehjes dhe shoqërimin, siç është paraparë në Nenin 6 të Traktatit për Bashkimin Evropian”.

- **Raporti i Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi implementimin e Vendimit Kornizë të Këshillit 2008/913/JHA lidhur me luftimin e formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë, me anë të së drejtës penale – COM (2014) 27 final**

### **Instrumentet e BE-së mbi mbrojtjen e të dhënave<sup>31</sup>:**

- Direktiva 95/46/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi mbrojtjen e individëve, lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të të dhënave të këtitilla.
- Vendimi Kornizë i Këshillit 2008/977/JHA mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara në kornizë të bashkëpunimit policor dhe gjyqësor për çështjet penale.
- Direktiva 2002/58/EC që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimit elektronik (ndryshuar me Direktivën 2009/136/EC.)
- Rregullativa (EC) 45/2001 mbi mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Komunitetit dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave.”

---

<sup>31</sup> Më 25 janar 2012, Komisioni ka propozuar një reformë të përgjigthshme të rregullave të BE-së për mbrojtjen e të dhënave, për të përforcuar të drejtat individuale (në veçanti të drejtat e privatësisë onlajn), për të trajtuar sfidat e globalizimit dhe teknologjitë e reja dhe për të rritur ekonominë dixhitale të BE-së. Propozimet përmbajnë [1] COM(2012) 11 final – Propozim për Rregullimin e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi mbrojtjen e individëve, lidhur me përpunimin e të dhënave personale për lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla (Rregullimi i përgjithshëm për mbrojtjen e të dhënave), COM (2012) 11 final dhe [2] COM(2012) 10 final – Propozimi i Direktivës së Parlamentit Evropian dhe Këshillit për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes penale të kundërvajtjeve ose dënimeve penale, dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, COM (2012) 10 final. Dy propozimet momentalisht ndodhen për diskutim në Këshill dhe në Parlamentin Evropian (procedurë e rregullt legislative).



